



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/174
Datë: 22.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-114 Për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. Paragrafi 1.1. i Vendimit të Qeverisë Nr. 10/156 të datës 23 gusht 2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 28/99 të datës 30 shtator 2022 për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, me qëllim të shtyrjes së afatit të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave si në vijim:

1.1. Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, do të mbahet nga data 5 prill 2024 deri me datën 17 maj 2024 .

2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 28/99 të datës 30 shtator 2022, dhe Vendimit Nr. 10/156 të datës 23 gusht 2023.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë